

Agjencia Kadastrale e Kosovës kontribon në hartën e Evropës gjeografike

Duke marrë parasysh peshën që ka një institucion gjithëpërfshirës i ekspertëve me me renome në botë në fushën e kadastrës dhe hartografisë, të qenit anëtar i plotfuqishëm në Eurogeographics sjell përfitime të mëdha për Republikën e Kosovës në përgjithësi dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës në veçanti, si në aspektin e ekspertizës po ashtu edhe në aspektin e identifikimit të fushave të interesit vendor, regjional dhe evropian ku bashkëpunimi do të sillte produkte kualitative kadastrale, hartografike dhe pronësore.

Për këtë arsye, pjesëmarrja e Agjencisë Kadastrale të Kosovës në Asamblenë e Përgjithshme të Eurogeographics-it, e cila u mbajt në Pragë të Republikës Çeke, ishte e rëndësishë së madhe si për nga përcjellja e trendeve zhvillimore evropiane, po ashtu edhe për prezantimin e aktivitetëve të AKK-së në këtë forum ekspertësh.

Gjatë aktivitetëve të ndryshme, prezantimit të sfidave me të cilat ballafaqohet Evropa gjeografike, diskutim rreth vizionit evropian në


fushën e ofrimit të të dhënave gjeohapësinore, delegacioni i AKK-së i prirë nga u.d Kryeshefi Ekzekutiv z. Avni Ahmeti ofroi gatishmëri që të kontribuojë me të dhënat e saja gjeohapësinore për nevojat e këtij rrjeti pan Evropian. Po ashtu, në takime të ndara me ish kryetaren e Eurogeographics Ingrid Vanden Berghe dhe me Kryetarin e ri të Eurogeographics Colin Bray, z. Ahmeti diskutoi edhe mënyrën e bashkëpunimit të ndërsjellët mes institucioneve përkatëse, që do të rezultonte me projekte konkrete.

Z. Ahmeti nga ky trup ekspertësh kërkoi informacion se me cilat të dhënat Republika e Kosovës do të mund të kontribuonte në hartën evropiane, dhe cilat janë të dhënat që AKK do të mund të shfrytëzonte prej Eurogeographicsit.

Z. Ahmeti u zotua në hapjen e të dhënave autoritative Kadastrale dhe hartografike, shpërndarja e të cilave nuk bie ndesh me legjislacionin vendor në fuqi, ndërsa nga Eurogeographics kërkoi mbështetje në harmonizimin dhe standardizimin e të dhënave

gjeohapësinore bazuar në standardet e BE-së dhe OKB-së. Po ashtu, kjo Asamble e Përgjithshme u shfrytëzua edhe për diskutim me përfaqësues të autoriteteve për kadastrë dhe hartografi të shteteve evropiane si Irlanda, Norvegjia, Holanda, Suedia, Turqia, Bosnja e Hercegovina, Armenia, Sllovenia etj.

Vlen të theksohet se Asambleja e sivjetme e Eurogeographics, e vlerësuar si më e madhja e mbajtur ndonjëherë, ku morën pjesë mbi 150 delegatë nga 46 shtete.



Sistemi i unifikuar i adresave - sinjalizimi i shenjave me emra rrugësh

Sistemi i adresave në vendet demokratike dhe të zhvilluara funksionon në formën më të mirë të mundshme ngase ka krijuar traditë afatgjate në shfrytëzim të adresave. Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemit unik të adresave në Republikën e Kosovës implementuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, është një nga shërbimet më të rëndësishme që pushteti lokal dhe qendror i siguron qytetarëve të Republikës së Kosovës. Sistemi unik, i saktë dhe i qëndrueshëm i adresave e përmirëson shërbimin ndaj qytetarëve duke e ngritur shkallën e kualitetit të shërbimeve, saktësinë dhe shpejtësinë e ofrimit të shpërbimeve dhe llojllojshmërinë e shërbimeve. Krijimi i Sistemit të Unifikuar të Adresave në Republikën e Kosovës është lansuar dhe mbështetur nga Zyra e BE-së në Kosovë, dhe i njëjti ka filluar të implementohet në dhjetor të vitit 2010. Gjithashtu projektin e ka mbështetur në vazhdimësi edhe Autoriteti për Hartografi i Norvegjisë, "Kartverket". Implementimin e Sistemit të Unifikuar të Adresave e bëjnë Agjencia Kadastrale e Kosovës në nivelin qendrorë kurse në nivelin lokal Komunitat përkrahësit Drejtoritë Komunalet e Urbanizmit.

Rezultatet e Arritura:

Qysh prej fillimit të implementimit të sistemit unik të adresave në Republikën e Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka mbledhur të dhënat në terren. Janë grumbulluar 22000 rrugë dhe 430000 hyrje të objekteve të cilat janë digjitalizuar. Agjencia Kadastrale e Kosovës ka zhvilluar edhe sistemin për administrimin e Regjistrat shtetërorë elektronik të adresave (ARIS). Prej ditës së fillimit të implementimit të sistemit të adresave, janë vendosur tabelat me emra të rrugëve në 26 komuna dhe 4 komuna janë në proces. Gjithashtu janë vendosur tabela të numrave të adresave në 12 komuna. E rëndësishme për tu theksuar është se shpërndarja e të dhënave të adresave është duke u bërë me 15 institucione publike dhe private, ndërsa është bërë edhe lidhja e adresave me regjistrat tjerë shtetëror si Agjencia e Regjistrat Civil, Agjencia e Statistikave të Kosovës etj. Agjencia Kadastrale e Kosovës ka arritur të krijojë kapacitete profesionale, respektivisht ka ngritur njësinë për sistemin e adresave brenda Agjencisë, si dhe ka kontribuar edhe në ngritjen e kapaciteteve në Komuna, respektivisht në drejtoritë e urbanizmit.

Çka nënkupton sistemi i adresave

Sistemi i adresave përfshinë emërtimin e çdo rruge në qytet. Sa i përket numrave ato do të vihen në këndet e rrugëve, në një tabelë, në mure të ndërtesave, ose në një shtyllë drejtuese. Çdo shtëpie do t'i vihet një numër.

Elementet e adresës sipas ligjit

Emri i Komunës
Emri i Fshatit
Emri i Zonës së Qarkullimit Publik në të cilin objekti ka një dalje
Numri i Ndërtesës
Numri i Hyrjes
Numri i Katit
Numri i Banesës
Kodi postar

Mirëmbajtja

Komunitat, zyrat e planifikimit urban bëjnë identifikimin e ndryshimeve dhe digjitalizimin përmes ARIS-it të rrugëve dhe objekteve të reja sipas kriterëve. Agjencia Kadastrale e Kosovës, Njësia e Sistemit të Adresave bën kontrollimin sipas ligjit dhe udhëzimeve administrative

Projekti i sinjalizimit të rrugëve



Moment nga nënshkrimi i marrëveshjes mes AKK dhe Kartverket

Si vazhdimësi e mbështetjes së Autoritetit për Hartografi të Norvegjisë për Sistemin e Adresave, është duke vazhduar projekti i prodhimit dhe instalimit të tabelave të emrave të rrugëve në katër komuna, Pejë, Gjiilan, Klinë dhe Kamenicë. Projekti ka rëndësi të madhe për sistemin e adresave, konkretisht për informimin e qytetarëve rreth emrave të rrugëve dhe orientimin në teren. Me kompletimin 4 komunave në fjalë, numri i komunave të kompletuara me tabela të emrave të rrugëve shkon në 30 komuna. Projekti implementohet nga Komunitat dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe pritet të zgjas 6 muaj. Agjencia Kadastrale e Kosovës në një takim pune me përfaqësues të Autoritetit Norvegjez

për Kadastër dhe Hartografi "Kartverket" dhe përfaqësues të operatorit ekonomik, të mbajtur me datë 24 shtator në AKK, ka nënshkruar marrëveshjen për implementimin e projektit për sinjalizimin e adresave dhe rrugëve në katër komuna, respektivisht në Komunitat Pejë, Gjiilan, Klinë dhe Kamenicë. Në takim përpos nënshkrimit të kontratës, janë diskutuar edhe për përgjegjësitë dhe obligimet e palëve gjatë implementimit të projektit. Ndërsa, si rezultat i një projekti të tillë, do të ngrihet kualiteti i sistemit të adresave, do të lehtësohet ofrimi i shërbimeve publike, dhe përfutet më të mëdhenj do të ishin vetë qytetarët dhe institucionet publike në Republikën e Kosovës.



Informata mbi AKK

AKK është organ kompetent për kadastër, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi, për sistem të adresave dhe infrastrukturë të të dhënave gjeohapësinore

Kontakte të rëndësishme

KRYESHEF EKZEKUTIV
Avni Ahmeti
Avni.Ahmeti@rks-gov.net

DREJTORATI I LGJOR
Ismet Kryeziu
Ismet.Kryeziu@rks-gov.net


DREJTORATI I FINANCAVE
DHE ADMINISTRATËS
Fazile Hamiti
Fazile.Hamiti@rks-gov.net

DREJTORATI I TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT
Afërdita Thaçi
Afërdita.Thaci@rks-gov.net

DREJTORATI I KADASTRËS
Korab Ahmetaj
Korab.Ahmetaj@rks-gov.net

QASJA E GRUAS NË PRONË
Ibadete Rexhepi
Ibadete.Rexhepi@rks-gov.net

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE
INFORMATA TË PËRGJITHSHME
akk@rks-gov.net



Infrastruktura kombëtare e informacioneve

hapësinore (IKIH)

IKIH, respektivisht Direktiva Europiane 2007/2 INSPIRE është e obligueshme për shtetet anëtare të BE-së, ndërkohë që është një kusht për vendet që aspiratojnë anëtarësimin në BE siç është Republika e Kosovës. Për ta thjeshtësuar atë, nuk ka anëtarësim në BE pa implementim të Direktivës INSPIRE. Në Republikën e Kosovës ka disa vite që kanë filluar aktivitete në fushën e IKIH, ndërsa sipas nenit 23 të Ligjit për Kadastër Nr. 04 /-L-013, thuhet se “Agjencia Kadastrale e Kosovës është përgjegjëse për koordinimin dhe krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore”. Agjencia Kadastrale e Kosovës si një organ përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të IKIH ka krijuar Ligjin për IKIH i cili ka kaluar së fundmi në Qeveri ndërsa pritet edhe aprovimi i tij nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Pavarësisht nga mungesa e Ligjit, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka ndërmarrë disa aktivitete në fushën e IKIH me kryesorin mes tyre zhvillimin e Gjeoportalit Shtetëror, një aplikacion i bazuar në ueb për grumbullimin

dhe shpërndarjen e të dhënave gjeohapësinore. Agjencia Kadastrale e Kosovës ka krijuar shërbimet e saj të internetit (ueb serviset) për produktet e veta si ortofotot, hartat topografike, kufijtë komunal, zonat kadastrale, kufijtë e parcelave, numrat e parcelave, segmentet rrugore, emrat e rrugëve, numrat e adresave etj, të cilat janë në dispozicion të qytetarëve, në çdo kohë dhe pa pagesë. Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë hartimit të Ligjit për IKIH ka identifikuar ofruesit kryesorë të të dhënave dhe përdoruesit e të dhënave që mund të përfitojnë nga ky ligj dhe nga këto aktivitete. Me disa prej tyre ka filluar bashkëpunimi, gjegjësisht shpërndarja e të dhënave dhe përdorimi i të dhënave përmes Gjeoportalit Shtetëror. Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, Departamenti për Tatimin në Pronë në Ministrinë e Financave, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komuna e Prishtinës, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale janë institucionet e para nga sektori publik që përveç AKK-së përdorin Geoportalin për

shpërndarjen e të dhënave , disa prej tyre si ofrues të të dhënave, ndërsa disa si përdorues të të dhënave. Mirëpo, duhet potencuar se të dhënat e ofruara nga këto institucione nuk janë në përputhje me direktivën INSPIRE. Kjo nënkupton që të dhënat nuk janë të harmonizuara, nuk ka meta të dhëna dhe nuk ka shërbim në internet (ueb servise). Teknisht, këto institucione i sjellin të dhënat në AKK si kopje fizike, ku pastaj ato ngarkohen në hapësirat virtuale të AKK, dhe prej aty këto të dhëna u ofrohen qytetarëve përmes Gjeoportalit. Por, kjo nuk është në përputhje me INSPIRE. Në vend të kësaj, këto institucione duhet të krijojnë shërbimet e tyre të internetit, të harmonizojnë të dhënat dhe të krijojnë meta të dhëna për të dhënat e tyre etj. AKK pret që me fillimin e projektit për regjistrim të pronës në kadastër dhe infrastrukturë të të dhënave hapësinore me përkrahje të Bankës Botërore, të ketë avancim në këto fusha.

Gjeoportali Shtetërorë



Gjeoportali Shtetërorë të cilin e administron Agjencia Kadastrale e Kosovës adreson të dhënat hapësinore për Republikën e Kosovës. Është plotësisht i integruar në SIKTK (Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën e Kosovës) si një komponent për shpërndarjen e të dhënave dhe të komunikimit me akterët e tjerë (publikun e gjerë dhe institucione të tjera). Geoportali gjithashtu shihet edhe si gurëthemel i IKIH me aftësinë për të ngarkuar dhe ruajtur të dhënat hapësinore nga anëtarë të ndryshëm.

Gjeoportali është komponent i SIKTK-së i ndarë nga komponentët e tjerë me një mur mbrojtës

(firewall). Të gjitha të dhënat dhe shërbimet nga SIKTK të cilat duhet të shpërndahen përmes Gjeoportalit Shtetërorë, së pari replikohen në anën e Hapur të Gjeoportalit të sistemit SIKTK. Gjeoportali është i bazuar në dy teknologji, në Open Source (Gjeoserver, Open Layers, GeoWebCache) dhe teknologjinë e Microsoftit (MS SQL Server), duke u mbështetur tërësisht në standardet dhe shërbimet e hapura OGC. Gjeoportali është ndërtuar në majë të CMS Liferay i cili siguron menaxhimin e përmbajtjes, të komunikimit dhe mekanizmat e sigurisë për komponentët e tjerë.

Të dhënat në gjeoportali

Ortofoto ndër vite
Harta topografike
Njësi kadastrale
Njësi administrative
Sistemi i adresave
Rrjetet referente
Rjeti rrugor
Rrjeti hekurudhur
Lumejt
Liqenet
Vendbanimet
Cenzusi
Statistika bujqësore
Zonat e mbrojtura
Zonat e vlerësimit (preliminare)
Shtresat e tokës
Meteorologjia



Matjet relative gravimetrike - Rrjeti shtetëror gravimetrik

PËRMES MATJEVE GRAVIMETRIKE PËRCAKTOHET GJEODI I SHTETIT, NDËRSA REPUBLIKA E KOSOVËS DERI MË SOT NUK E KA PAS TË PËRCAKTUAR GJEODIN E SAJ, DHE KA SHFRYTËZUAR GJEODIN EVROPIAN. NDËRSA, GJEODI ËSHTË I NEVOJSHËM PËR SECILIN SHTET SIDOMOS PËR PËRCAKTIMIN E LARTËSIVE MË TË SAKTA PËR SIPËRFAQE MË TË VOGLA.


AKK si institucion qëndror për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave gjeodezike ka ndërmarrë edhe aktivitetet e zhvillimit të rrjetit gravimetrik për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Detyra themelore e gjeodezisë është matja dhe hartografimi i sipërfaqes së Tokës. Ky përkufizim klasik zgjerohet në kohët moderne edhe me aspektin fizik, sepse fusha gravitacionale e Tokës ndikon jo vetëm në cilësinë e matjeve gjeodezike dhe hartave, ndaj edhe duhet dhënë asaj rëndësinë që ka në procesin e modernizimit të referencës vertikale në shkallë lokale dhe globale. Për të mundësuar modelimin e fushës gravitacionale, përfshirë këtu edhe përcaktimin e Gjeodit Kombëtar për territorin e Republikës së Kosovës, model që do të na mundësojë

pozicionim 3D vetëm duke përdorur pajisje të pozicionimit global GNSS dhe pozicionim që do të kënaqë edhe kërkesat e projekteve të ndryshme inxhinierike me shtrirje të madhe territoriale, del i nevojshëm përcaktimi i gravitetit për një numër të caktuar pikash të shpërndara uniformisht në territorin e vendit. Fillimisht AKK në vitin 2016 ka zhvilluar Rrjetin Gravimetrik Absolut të Rendit Zero, i cili rrjet do të shërbejë si bazë mbi të cilën mbështetet ngritja e Rrjetit Shtetëror Gravimetrik. Rrjeti i Rendit 0, në Kosovë konsiston nga dy pika gravimetrike absolute (AGP), graviteti absolut i të cilave do të matet çdo 10 vjet, ndërsa vendndodhja e tyre është në Prishtinë (AGP 01) dhe Prizren (AGP 02).

Për të kompletuar zhvillimin e rrjetit gravimetrik

në tërë territorin e Kosovës, AKK këtë vit do të përfundojë projektin-fazën e parë për Rrjetin Gravimetrik. Në kuadër të këtij projekti janë paraparë aktivitetet si ndërtimi dhe matja e 12 Pikave Gravimetrike të Rendit të Parë që mbulojnë tërë territorin e Kosovës, ndërtimi dhe matja e 6 pikave Ekscentrike rreth pikave të Rendit 0 në Prishtinë dhe Prizren, si dhe matja e 200 pikave gravimetrike të rendit të dytë në regjionin e Prishtinës (shpërndarja e pikave të rendit të dytë do të jetë metodë e kombinuar, çdo 2 km 150 pika si dhe çdo 5 km 50 pika. AKK planifikon që vitin e ardhshëm të përfundojë me matjet gravimetrike në tërë territorin e Kosovës, çka do të mundësojë llogaritjen e Gjeodit të saktë lokal.



Vendndodhja e pikave Gravimetrike Absolute

Pse janë të nevojshme matjet gravimetrike

Ritja e saktësisë dhe efikasitetit të matjeve gravimetrike, veçanërisht në përcaktimin e gravitetit absolut, ka zgjeruar në mënyrë substanciale aplikimin e gravitetit në gjeodezi dhe në teknikat e sakta që përdoren në gjeodinamikë duke çuar në përdorimin e këtyre të dhënave edhe për qëllimet e reduktimit të matjeve gjeodezike dhe astronomike në nivelin e detit, llogaritjen e korekturave në nivelimin e saktësisë së lartë, interpolimin e shmangjes së vertikales, përcaktimin e formës së Tokës, etj.



Gravimetri relativ në pikën absolute gravimetrike